



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

Tiranë, mars 2025

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në ligjin nr. 114, datë 25.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 28.10.2016 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020, “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”, dhe programin e angazhimit të auditimit nr.27/1, datë 20.1.2025, Drejtoria e Auditimit kreu verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet.

Auditimi i kryer synoi, në përmbushjen e objektivave audituese:

i) Të ndihmojë institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet, në marrjen e sigurisë që gjetjet e auditimit janë adresuar në mënyrën e duhur dhe rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit janë zbatuar sipas afateve dhe kriterëve të kërkuara.

ii) Vlerësimi i përshtatshmërisë, efektivitetit të veprimeve të ndërmarra nga titullari i subjektit të audituar për gjetjet e auditimit, veprimet korrigjuese dhe parandaluese të ndërmarra, përmirësimit të sistemeve, procedurave dhe rregullave.

Objekti i auditimit të ushtruar, në Komitetin Shtetëror për Kultet :

- Vlerësimi i adresimit të gjetjeve të auditimit të brendshëm nga menaxhimi i institucionit, i zbatimit të rekomandimeve të dhëna, në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve dhe kriterëve të miratuara. Funksionimi i kontrollit të brendshëm për zbatimin e rekomandimeve, menaxhimi i risqeve të përgjithshme, identifikimi i mangësive dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese.

Auditimi u krye përgjatë periudhës 20.1.2025-25.2.2025.

Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara, sipas drejtimeve të auditimit rezultojnë:

Drejtorja e Auditimit, bazuar në Programin e angazhimit të auditimit nr.3316/1, datë 24.6.2024 ka kryer auditim, rezultatet e të cilit janë përcjellë në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet, me shkresën nr. 3316/4, datë 2.9.2024 “Dërgim i raportit përfundimtar dhe i planit të zbatimit të rekomandimeve”, duke adresuar për zbatim rekomandime sipas kategorive:

- 8 rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm,
- 7 rekomandime për masa organizative,
- 1 rekomandim të përmirësimit të kuadrit rregullator.

Në Ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, pika d, neni 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” përcaktohet që: *Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar”.*

Nga verifikimi rezultoi se nga titullari i institucionit, është proceduar konform përcaktimit të pikës d, të nenit 12, të ligjit nr. 114/2015, i ndryshuar dhe me shkresën nr. 3316/5, prot., Kryeministri, datë 25.9.2024, është përcjellë plani i veprimit i miratuar me afate të përcaktuara dhe personat përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve.

Sipas plan veprimit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton se janë miratuar dhe pranuar në masën 100 % rekomandimet e dhëna.

Nga verifikimi i kryer për zbatimin e rekomandimeve nga 16 rekomandime të klasifikuara sipas kategorive të adresuara, rezultojnë 14 rekomandime të zbatuara dhe dy rekomandime në proces zbatimi.

Nuk rezultojnë rekomandime të pazbatuara.

Për dy rekomandimet me status në proces zbatimi, u riadresuan edhe një herë.

Më poshtë paraqesim, nivelin e pranimit dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Subjekti i audituar	Rekomandime të dhëna	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime në proces zbatimi	Rekomandime të pazbatuara
1	Rekomandime për përmirësim sistemi	8	8	8	0	0
2	Rekomandime për masa organizative	7	7	5	2	0
3	Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor	1	1	1	0	0
Totali		16	16	14	2	0

Sa më sipër vlerësohet pozitivisht qëndrimi mbështetës i titullarit të institucionit, ndaj rekomandimeve të dhëna nga auditimi, kjo me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Opinion i përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

- Referuar auditimit të kryer sipas procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, konstatimeve të evidentuara në raportin e auditimit;
- Në zbatim të Standardit Ndërkombëtar për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (IPPF) 2450 “Opinionet e Përgjithshme”;
- Bazuar në vlerësimet e kryera mbi krijimin, vendosjen dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshëm, mbështetur në informacion të mjaftueshëm, të besueshëm, të duhur dhe të dobishëm;

Opinionin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm, rezulton si më poshtë vijon:

Opiniononi i vlerësimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm	Përshkrimi i opinionit, baza e opinionit ¹
Niveli 2-Sistem pjesërisht efektiv Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon efektivisht/mirë por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave.	Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në mënyrë efektive, por u gjetën disa mangësi të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirësime në disa drejtime.

HYRJE

Auditimi u krye në përputhje me programin e miratuar me nr. 27/1 prot., datë 20.1.2025 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm”.

Rekomandimet objekt auditimi janë adresuar institucionit me shkresën nr. 3316/4, datë 2.9.2024, për auditimin e ushtruar në këtë institucion për periudhën objekt auditimi 1.1.2023-30.4.2024 .

Takimi fillestar, u zhvillua në datë 20.1.2025 midis znj. Luljeta Nano, Drejtore e Drejtorisë së Auditimit, znj. Engjellushe Ibraliu, Përgjegjëse grupi, dhe znj. Erjona Hoxha, anëtar grupi me Kryetarin e Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodjan Bulku dhe Nëpunësin zbatues znj. Dorina Vidrica.

Në takim u prezantua qëllimi, programi i punës, tematika dhe objektivat e auditimit.

Palët ranë dakord për fillimin e auditimit dhe kushtet e punës.

Qëllimi i auditimit është që të ndihmojë institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet, në marrjen e sigurisë që gjetjet e auditimit janë adresuar në mënyrën e duhur dhe rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit janë zbatuar sipas afateve dhe kriterëve të kërkuara. Vlerësimi i përshtatshmërisë, efektiviteti dhe koha e veprimeve të ndërmarra nga titullari i subjektit të audituar për gjetjet e auditimit, veprimet korrigjuese dhe parandaluese të ndërmarra, përmirësimi i sistemeve, procedurave dhe rregullave.

Në përfundim të misionit të auditimit në institucion, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u krye takimi ballafaques më datë 28.2.2025 me Titullarin dhe Nëpunësin zbatues. Gjatë këtij takimi nga grupi i auditimit u bënë prezent, gjetjet dhe rekomandimet si dhe u dakortësuan afatet e zbatimit të tre rekomandimeve që rezultuan në proces.

Me shkresën nr. 27/2 prot. Kryeministri, datë 11.3.2025, projekt raporti i auditimit, u adresua institucionit Komitetit Shtetëror për Kultet, për tu njohur me gjetjet dhe rekomandimet për marrjen e masave për përmirësimin e funksionimit të sistemeve.

Me shkresën nr.27/3 datë 26.3.2025 prot. Kryeministri, është përcjellë projekt raporti i auditimit (një kopje) i konfirmuar. Në këtë shkresë, institucioni relatton se dy rekomandime, që në projekt raport, rezultojnë në proces zbatimi, janë zbatuar. Në përfundim të misionit të

¹ Citimi i Standardit Ndërkombëtar për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm IFPP 2450 “Opinionet e Përgjithshme”.

auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u hartua ky raport, i cili i vihet në dispozicion institucionit.

II. METODA DHE TEKNIKAT E AUDITIMIT

Metoda e auditimit: Në funksion të arritjes së objektivave dhe përmbushjes së angazhimit të auditimit, është përdorur metoda e ekzaminimit të planit të veprimit të miratuar, i dërguar nga institucioni, në Drejtorinë e Auditimit; të përgjigjeve mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, të veprimeve të ndërmarra nga menaxhimi si dhe verifikimi i evidencave mbështetëse argumentuese dhe justifikuese.

Teknikat e auditimit: Për të arritur në konkluzione profesionale, janë kombinuar teknikat:

- vlerësim i rregullshmërisë së akteve të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve, urdhra dokumente, rregullore etj;
- rindërtimi i ngjarjeve, mbështetur në radhën kronologjike të dokumentacionit;
- ndjekja e dokumentacionit, gjurmim dokumentacioni sipas rrjedhës e modelit standard;
- rishikimi analitik, rishikimi i dokumentacionit deri tek dokumentacioni fillestar;
- informacionet e marra nga stafi i institucionit.

III. BAZA LIGJORE

- Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
- Manuali i auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Standardet Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm.
- Udhëzimi i Ministrit të Ministrisë të financave dhe të Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.
- Plan veprimi i miratuar nga drejtuesi i subjektit të audituar për zbatimin e rekomandimeve.
- Urdhra, vendime të titullarit të subjektit të audituar dhe korrespondenca shkresore që lidhet me zbatimin e rekomandimeve.
- Si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nën ligjore që lidhet me veprimtarinë e subjektit dhe misionin e auditimit.

IV. GJETJET KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM.

Auditimi u krye në përputhje me programin e miratuar me nr.27/1 prot., datë 20.1.2025, nga i cili rezultoi si më poshtë:

IV.1 Plani i veprimit i miratuar me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 3316/4, datë 2.9.2024 “Dërgim i raportit përfundimtar dhe i planit të zbatimit të rekomandimeve”.

Drejtoria e Auditimit, bazuar në programin e angazhimit të auditimit nr. 3316/1, datë 24.6.2024 ka kryer auditim për periudhën 1.1.2023 deri në 30.4.2024, rezultatet e të cilit janë përcjellë në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet me shkresën nr. 3316/4, datë 2.9.2024 “Dërgim i raportit përfundimtar dhe i planit të zbatimit të rekomandimeve”.

Nga verifikimi rezultoi se nga titullari i institucionit, është proceduar konform përcaktimit të pikës d, të nenit 12, të ligjit nr. 114/2015, i ndryshuar dhe me shkresën nr. 3316/5, prot., Kryeministri, datë 25.9.2024, është përcjellë plani i veprimit i miratuar, me afate të përcaktuara dhe personat përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve.

IV.2 Niveli i pranimit/mospranimit të rekomandimeve, shkaqet dhe arsyet e mospranimit.

Sipas plan veprimit të miratuar nga titullari, dërguar me shkresën nr. 3316/5, prot., Kryeministri, datë 25.9.2024, të gjitha rekomandimet e raportit përfundimtar të auditimit, **janë pranuar 100 %**.

IV.3 Verifikimi i progresit të bërë për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, adresuar me shkresën nr. 3316/4, datë 2.9.2024 “Dërgim i raportit përfundimtar dhe i planit të zbatimit të rekomandimeve”.

IV.3.1. Masat e ndërmarra në zbatimin e rekomandimeve, statusi i tyre.

Nga verifikimi statusi i zbatimit të rekomandimeve rezulton:

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 1 :

(a) Të merren masa që gjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, të kryhet identifikimi i risqeve dhe lista e risqeve prioritare, t’i bashkëngjitet kërkesave buxhetore, që i dorëzohen Ministrisë së Financave.

(b) Të merren masa për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut, sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut, krijimi i Ekipit të Menaxhimit të Riskut”.

Afati: Rekomandimi a) Në vijimësi sipas afateve të dërgimit të PBA-së në Ministrinë e Financave. Rekomandimi b) Deri në 20 tetor 2024.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, EMR, Nëpunësi zbatues. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar

Veprimet e ndërmarra:

Nga auditimi për zbatimin e rekomandimit 1(a) u konstatua se gjatë procesit të programit buxhetor afatmesëm, është kryer identifikimi i risqeve, si dhe lista e risqeve prioritare i është bashkëngjitur kërkesave buxhetore dërguar Ministrisë së Financave, PBA 2025-2027, Faza II, nr. 192/1 prot., datë 02.09.2024. Për zbatimin e rekomandimit 1(b) u konstatua se me Urdhrin nr. 48, datë 29.8.2024 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut, në mbështetje të Udhëzimit nr.16, datë 20.7.2016.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 2:

Nëpunësi zbatues ti propozojë titullarit për miratim pasi të jenë shqyrtuar dhe miratuar më parë nga GMS, gjurmët e auditimit për:

a-Procedurat për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm.

b-Procedurat për monitorimin e performancës buxhetore dhe të objektivave.

c-Procedurat për kryerjen e prokurimeve, duke filluar që nga faza e identifikimit të nevojave deri në përfundimin e procedurave të prokurimit.

d-Procedurat për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e fondeve të alokuara bashkësive fetare për mbështetje financiare.

Afati: Deri në 20 janar 2025.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, GMS, Nëpunësi zbatues, (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi u konstatua se me Urdhrin nr. 10, datë 16.1.2025 janë miratuar gjurmët e auditimit për:

a-Procedurat për përgatitjen e dokumentit të Projekt Buxhetit Afatmesëm.

b-Procedurat për monitorimin e performancës buxhetore dhe të objektivave.

c-Procedurat për kryerjen e prokurimeve, duke filluar që nga faza e identifikimit të nevojave deri në përfundimin e procedurave të prokurimit.

d-Procedurat për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e fondeve të alokuara bashkësive fetare për mbështetje financiare.

Gjurmët e auditimit, janë miratuar dhe nga GMS, bazuar në procesverbalin nr. 29 prot., datë 16.1.2025.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 3 :

Nga nëpunësi zbatues, të merren masa që në raportet e monitorimit të performancës buxhetore në relacionin shpjegues, të përfshihen dhe analizat faktoriale të realizimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për mallra dhe shërbime.

Afati: Sipas afateve të dërgimit të raporteve të monitorimit të buxhetit në Ministrinë e Financave

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, EMP, GMS, Nëpunësi zbatues. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi janë konstatuar se është përfshirë analiza faktoriale e realizimit të fondeve buxhetore për shpenzimet, mallra dhe shërbime, në relacionin shpjegues nr.218/1, datë 30.09.2024, të raporteve të monitorimit të performancës buxhetore për 8-mujorin e vitit 2024. Gjithashtu raportet e monitorimit të performancës buxhetore për vitin 2024, do të dërgohen brenda afatit, shkurtit të vitit 2025.

Rekomandim për përmirësimin e kuadrit ligjor nr. 4 :

Nga KSHK, të merren masa që në relacionin dhe projekt vendimin “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” që KSHK, paraqet çdo vit në institucionin epror, në vend të emërimit “punonjës të institucioneve

të arsimit parashkollor, para universitar dhe universitar” të përdoret emërtimi “arsimtarë të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar”.

Afati: Në vijimësi.

Statusi: Pranuar. ((Referuar shkresës së KSHK nr. nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Nëpunësi zbatues, Komiteti. ((Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Në shkresën nr.27/3 datë 26.3.2025 prot. Kryeministri, dërguar nga KSHK, “Dërgohet projekt raporti i auditimit”, theksohet se ky rekomandim është zbatuar. Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur nga KSHK, shkresa me nr.99 prot., datë 26.3.2025, dërguar institucionit epror, lënda: “Dërgohet planifikimi i ndarjes së fondit për bashkësitë fetare për vitin 2025”, ku bashkëlidhur është edhe projekt vendimi. Konstatohet se rekomandimi është zbatuar.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 5:

Të merren masa që nga ana e KSHK-së, të bashkëpunohet me bashkësitë fetare për rregullshmërinë e plotësimit të formularëve të kërkesave për aplikim për fonde. Bashkëlidhur formularëve të aplikimit të paraqiten dhe deklaratat e listë pagesave të sigurimeve shoqërore/shëndetësore të muajit të fundit, që përkon me periudhën e dërgimit të cilat shërbejnë si evidenca argumentuese të fondeve të kërkuara për mbulimin e pagave të punonjësve të administratës dhe të arsimtarëve nga bashkësitë fetare.

Afati: Deri në 30 nëntor 2024 dhe në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr. nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Nëpunësi zbatues, Komiteti. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimit u konstatua se institucioni ka adresuar e mail bashkësive fetare për dërgimin e kërkesave për mbështetje financiare për vitin 2025. (e maili i datës 24.9.2024). Për vitin 2025, nga bashkësitë fetare janë adresuar kërkesat për aplikim për fonde sipas shkresave të mëposhtme.

KOASH: Shkresa nr. 229/1 prot., datë 24.09.2024

KMSH: Shkresa nr. 441 prot., datë 09.10.2024

KBB: Shkresa nr. 531 prot., datë 31.10.2024

KISH: Shkresa nr. 63 prot., datë 21.11.2024.

Rekomandim për masa organizative nr. 6 :

(a) Në funksion të ndjekjes dhe mbikëqyrjes së fondeve e të alokuara për bashkësinë fetare KBB me destinacion pagat e punonjësve të administratës, të fondit për investimet apo fondit vjetor të alokuar për shkak të pozitës së veçantë si kryegjyshatë botërore me qendër në Tiranë, të merren masa që të bashkëpunohet me KBB për paraqitjen në mënyrë periodike në KSHK:

i) për fondet e pagave të administratës të paraqiten deklaratat e listë pagesave të sigurimeve shoqërore/shëndetësore, ii) për fondet e investimeve dhe fondin vjetor të alokuar, për shkak të pozitës së veçantë si kryegjyshatë botërore, të paraqiten me shkresë shoqëruese (e cila të pasqyrojë në mënyrë të detajuar referencat e dokumenteve të shpenzimeve të periudhës raportuese) dokumentet respektive të shpenzimeve të kryera.

Afati: Rekomandimi a) Menjëherë dhe në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Nëpunësi zbatues, Komiteti. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi i kryer rezultoi se në zbatim të rekomandimit 6.a, nga KBB janë paraqitur pranë KSHK shkresat si më poshtë vijon:

-Shkresa nr. 376 prot., datë 16.07.2024 me periudhë mbulimi janar-qershor 2024.

-Shkresa nr. 40 prot., datë 28.01.2025, me periudhë mbulimi korrik-dhjetor 2024.

-Shkresa nr. 375 prot., datë 16.07.2024 me periudhë mbulimi janar-korrik 2024.

-Shkresa nr. 382 prot., datë 23.07.2024 me periudhë mbulimi qershor 2023-qershor 2024

Rekomandim për masa organizative nr. 7 :

a)Me qëllim të realizimit të një procesi efektiv të planifikimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së fondeve për financimin e bashkësive fetare, konform përcaktimit të nenit 10 të Ligjit nr.10140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” dhe nenit 3, pika 8, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Komitetit Shtetëror për Kultet, miratuar me Urdhrin nr. 77, datë 16.5.2018, të Kryeministrit, të merren masa që rregullshmëria e planifikimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së mënyrës së përdorimit të fondeve, të jenë objekt shqyrtimi në mbledhjet e Komitetit, përgjatë vitit, duke proceduar me dokumentimin e procesit, konform përcaktimit të nenit. 9 “Mbledhja e komitetit shtetëror për Kultet” të Rregullores së Brendshme Organizimit dhe Funksionimit.

(b)KSHK të marrë masa për evidentimin, analizimin e dokumenteve që justifikojnë shpenzimet e kryera në përputhje me qëllimin dhe destinacionin e fondeve të alokuara për KBB-në vitin 2023 dhe në vijim.

Afati: 7.a Në vijimësi: 7.b 10 Janar 2025 dhe në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Anëtarët. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Në proces zbatimi

Veprimet e ndërmarra: Në informacionin e paraqitur grupit të auditimit, nr. 7/3, datë 20.2.2025, në zbatim të rekomandimit 7.a KSHK thekson se: “Në zbatim të Rregullores së Brendshme Organizimit dhe Funksionimit (neni 9) shqyrtimi i rregullshmërisë së planifikimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së mënyrës së përdorimit të fondeve, pasi përfundon plotësimi i dokumentacionit dhe përgatitja e projektvendimit, ky i fundit kalon për miratim në mbledhjen e anëtarëve, e cila do të bëhet në muajin prill 2025, në zbatim të Rregullores së Brendshme Organizimit dhe Funksionimit (neni 9). Bashkësitë fetare kanë plotësuar tabela dhe të dhënat për secilën bashkësi, të cilat i janë përmbajtur plotësisht formatit. KSHK është drejt mbylljes përfundimtare të dokumentacionit të plotë, në respektim të afateve që ka ky proces. Pasi miratohet tek anëtarët në mbledhjen e Komitetit, KSHK si institucion bashkërendues mes Këshillit të Ministrave dhe bashkësive fetare, ndihmon në hartimin e një projektvendimi bazuar në gjithë procesin dhe bazën ligjore të sipërcituar mbi financimin e tyre, të cilit i bashkëngjitet i skanuar dhe dokumentacioni i plotë për secilën bashkësi fetare, dhe i dërgohet i gjithë materiali Këshillit të Ministrave, i cili ka autoritetin e vendimmarrjes””.

Gjithashtu në informacionin e dhënë theksohet se: KSHK ka konstatuar se rregullorja e brendshme e saj me nr.77, datë 16.5.20218 duhet të ketë ndryshime, duke marrë parasysh veprimtarinë e saj dhe duke patur në vëmendje bashkërendimin me Rregulloren e Brendshme të Kryeministrit, ku përcaktohet qartë koordinimi dhe bashkërendimi i udhëzimeve dhe urdhrave me institucionet e varësisë miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.74, datë 9.6.2023

“Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Për organizimin e Kryeministrit”. KSHK do të bëjë një përshtatje të organizimit dhe funksionimit për të përmbushur bashkërendimin e detyrave si organ varësie i Kryeministrit me statusin e institucionit bashkërendues, sipas VKM nr.459, datë 23.9.1999”.

Përsa i përket rekomandimit 7.b rezulton se janë evidentuar shkresat e adresuara nga KBB referuar shpenzimeve të kryera por për vitin 2023 nuk janë kryer analiza. Sikurse relatuar më lart, dhe adresuar nga KSHK, pas përfundimit të plotësimit të dokumentacionit dhe përgatitjes së projekt vendimit do të kalojë për shqyrtim/miratim në mbledhjen e anëtarëve, mbledhje e cila do të bëhet brenda muajit prill 2025.

Nga auditimi rezultoi se përgjatë vitit 2024 nga bashkësitë fetare janë adresuar shkresat me dokumentet justifikues si më poshtë vijon:

KMSH:	Periudha e mbulimit
Shkresa Nr. 263 prot., datë 10.06.2024	Janar-prill 2024
Shkresa Nr. 442 prot., datë 09.10.2024	Maj-gusht 2024
Shkresa Nr. 24 prot., datë 23.01.2025	Shtator-dhjetor 2024
KISH:	Periudha e mbulimit
Shkresa Nr. 53 prot., datë 13.09.2024	Janar-qershor 2024
Shkresa Nr. 59 prot., datë 15.10.2024	Korrik-gusht 2024
Shkresa Nr. 62 prot., datë 21.11.2024	Shtator 2024
Shkresa Nr. 71 prot., datë 30.12.2024	Tetor 2024
KOASH:	Periudha e mbulimit
Shkresa Nr. 123/1 prot., datë 15.05.2024	Janar 2024
Shkresa Nr. 124/1 prot., datë 15.05.2024	Shkurt 2024
Shkresa Nr. 125/1 prot., datë 15.05.2024	Mars 2024
Shkresa Nr. 18/1 prot., datë 27.01.2025	Prill 2024
Shkresa Nr. 19/1 prot., datë 27.01.2025	Maj 2024
Shkresa Nr. 20/1 prot., datë 27.01.2025	Qershor 2024
Shkresa Nr. 21/1 prot., datë 27.01.2025	Korrik 2024
Shkresa Nr. 22/1 prot., datë 27.01.2025	Gusht 2024
Shkresa Nr. 24/1 prot., datë 3.2.2025	Shtator 2024
Shkresa Nr. 25/1 prot., datë 3.2.2025	Tetor 2024
KBB:	Periudha e mbulimit
Shkresa Nr. 375 prot., datë 16.07.2024	Janar-qershor 2024
Shkresa Nr. 382 prot., datë 23.07.2024	Qershor 2023-qershor 2024
Shkresa Nr. 40 prot., datë 28.01.2025	Korrik-dhjetor 2024

Gjetja nr. 1. Mbi planifikimin dhe ndjekjen e fondeve për financimin e bashkësive fetare.	
Subjekti i audituar	KSHK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Titullari, Komiteti, Nëpunës zbatues.
Përmbledhja e bazës ligjore	-Ligji nr.10140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, -Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Komitetit Shtetëror për Kultet miratuar me Urdhrin nr. 77 datë 16.5.2018 të Kryeministrit.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: Në shkresën nr.27/3, datë 26.3.2025 prot. Kryeministri, dërguar nga KSHK, “Dërgohet projekt raporti i auditimit”, theksohet se: Rekomandimi është realizuar. Ky rekomandim është shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Kultet të datës 4 mars 2025. Konstatohet se mbledhja e komitetit sipas

	citimit në shkresë është realizuar pas përfundimit të afatit të kryerjes së auditimit në terren që ishte data 25.2.2025 dhe verifikimi i dokumentacionit respektiv do të kryhet në periudhën në vijim. Sa më sipër ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi e do të riadresohet dhe një herë në funksion të zbatimit të tij në vijimësi. Kriteri: Neni 10, i Ligjit nr.10140, datë 15.5.2009; Pika 8, e nenit 3 e Urdhrit nr. 77, datë 16.5.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizmit dhe funksionimit të Komitetit Shtetëror për Kultet”. Ndikimi efekti: Evidentimi, analizimi dhe ndjekja në vijimësi e fondeve jep garanci KSHK-së mbi alokimin e fondeve në përputhje me qëllimin dhe destinacionin sikurse përcaktuar në VKM-në respektive.
Niveli i Riskut	I lartë
Konkluzioni	Rekomandimi adresohet në funksion të përmirësimit të sistemit të planifikimit ndjekjes dhe mbikëqyrjes së fondeve.
Rekomandim	Me qëllim realizimin e një procesi efektiv të ndjekjes dhe mbikëqyrjes së fondeve për financimin e bashkësive fetare, konform përcaktimit të nenit 10 të Ligjit nr.10140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” dhe nenit 3, pika 8, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Komitetit Shtetëror për Kultet, miratuar me Urdhrin nr. 77, datë 16.5.2018, të Kryeministrit, nga KSHK të merren masa, që rregullshmëria e planifikimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së mënyrës së përdorimit të fondeve, të jenë objekt shqyrtimi në mbledhjet e Komitetit, duke proceduar me dokumentimin e procesit, konform përcaktimit të nenit 9, “Mbledhja e komitetit shtetëror për Kultet” të Rregullores së Brendshme Organizimit dhe Funksionimit.
Afati i fundit zbatimit të Rekomandimit	<i>Në vijimësi.</i>
Statusi rekomandimit	Pranuar.

Rekomandim për masa organizative nr. 8:

Nga KSHK të merren masa që në bashkëpunim me bashkësitë fetare të përditësohen të dhënat me aktet e miratimit të listës së institucioneve nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose nga Këshilli i Ministrave.

Afati: Në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, anëtarët. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimit u konstatua se me shkresën nr.266, datë 11.12.2024 KSHK u ka kërkuar bashkësive fetare, informacion në lidhje me institucionet arsimore sipas një formati të caktuar.

Rekomandim për masa organizative nr. 9 :

Të hartohen dokumentet e përshkrimit të punës për pozicionet specialist jurist dhe specialist arkiv/protokolli, konform përcaktimit të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar.

Afati: Deri në 20 nëntor 2024

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Specialist i ngarkuar me BNJ. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi rezultoi se janë hartuar përshkrimet e punës për pozicionet specialist jurist dhe specialist arkiv/protokolli, në zbatim të VKM nr. 142, datë 12.3.2014, i ndryshuar, dhe janë dërguar në institucionin epror, me shkresën nr. 249, datë 19.11.2024.

Rekomandim për masa organizative nr. 10:

Në funksion të përmirësimit të funksionimit të sistemit të prokurimeve të merren masa si më poshtë vijon:

a) Personi përgjegjës për prokurimet i caktuar me urdhër të titullarit, të mos kryejë funksionet e nëpunësit zbatues.

b) Të dokumentohet procesi i përcaktimit të fondeve për çdo objekt prokurimi të parashikuar në regjistër (kontrata të mëparshme, studim tregu, etj.)

c) Të kryhet inventarizimi i dosjeve të prokurimit për vitin 2023.

Afati: a) Menjëherë dhe në vijimësi. b) Në vijimësi. c) Deri në 20 dhjetor 2024..

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024)

Personat e ngarkuar: Titullari, Personi Përgjegjës për prokurimet. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimit u konstatua se: a) me Urdhrin nr. 3/1, datë 03.9.2024 është caktuar personi përgjegjës për prokurimet i cili nuk kryen funksionet e nëpunësit zbatues; b) është hartuar procesverbali i datë 30.12.2024, për përgatitjen e regjistrit të prokurimeve për vitin 2025 të KSHK-së, si dhe përcaktimi i fondeve për çdo objekt prokurimi të parashikuar në regjistër; c) me procesverbalin e datës 19.12.2024 është dorëzuar në arkivin e institucionit dosja e prokurimit për vitin 2023.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 11 :

Të merren masa që për çdo rast të dërgimit të drejtuesit të automjetit me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit të nxirret autorizim i titullarit, konsideruar si dokumentacion urdhëruar për pagesën e shpenzimeve për dieta brenda vendit.

Afati: Në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Titullari, Nëpunësi zbatues. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Për realizimin e rekomandimit u konstatua se për çdo rast të dërgimit të drejtuesit të automjetit me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit, nga titullari i institucionit ka dalë autorizimi përkatës. Përmendim: Autorizimi i datës 2.9.2024, Autorizimi i datës 14.10.2024. Konstatohet se autorizimet e mësipërme janë konfirmuara nga titullari i institucionit.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 12 :

Të merren masa për nxjerrjen e udhëzimit të brendshëm për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen në kuadrin e organizimit të punës për sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët.

Afati: Deri në 20 janar 2025.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Titullari, Nëpunësi zbatues, Specialist jurist, Grupi i punës i ngritur nga titullari. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi u konstatua se për realizimin e rekomandimit është nxjerrë Urdhri nr. 64, datë 3.12.2024 “Për caktimin e personit për sigurimin e hoteleve me kosto sa më të ulët” dhe Udhëzimi nr. 1, datë 3.12.2024 “Mbi organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me kosto të ulët për punonjësit e KSHK, në shërbimet jashtë vendit”.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 13:

Të merren masa që dokumentet e mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave të përpilohen për çdo rast të bërjes hyrje apo dalje të mjeteve monetare në valutë dhe të regjistrohen në librin e arkës në valutë.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Nëpunësi zbatues, arkëtari. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës shtator 2024 - janar 2025 nuk ka patur hyrje-dalje të mjeteve monetare në valutë.

Rekomandim për masa organizative nr. 14:

a) Komisioni i inventarizimit, përgjatë procesit të inventarizimit të marrë masa që kartelat inventariale në ngarkim/përdorim të punonjësve/magazinierit (duhet të përmbajnë të dhënat kontabël, të dhënat nga inventarizimi fizik dhe diferencat nga inventarizimi nëse ka) të konfirmohen si nga anëtarët e komisionit dhe nga punonjësi/magazinieri me përgjegjësi materiale.

b) Nga titullari të merren masa për analizimin shqyrtimin e rezultateve të inventarizimit të kryer referuar urdhrin nr. 58, datë 4.12.2023, “Për inventarizimin e inventarit të imët të aktiveve në përdorim dhe vlerave materiale për vitin 2023” dhe të zbatohen procedurat për rikuperimin e vlerës së aktivitetit të rezultuar me diferencë, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 të ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Afati: Rekomandimi a) Në vijimësi. Rekomandimi b) Deri në 20 janar 2025.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Titullari, Komisioni i inventarizimit, Nëpunësi zbatues, Magazinieri. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Për zbatimin e rekomandimit 14 (a) u konstatua se gjatë procesit të inventarizimit të kryer më urdher të titullarit nr. 76, datë 29.12.2024, kartelat inventariale në ngarkim/përdorim të punonjësve/magazinierit përmbajnë të dhënat kontabël, të dhënat nga inventarizimi fizik si dhe kartelat janë të konfirmuara nga komisioni dhe magazinieri.

Për zbatimin e rekomandimit 14 (b), u konstatua se me Urdhrin nr. 72, datë 16.12.2024 është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim nga subjekti të aktivitetit të rezultuar me diferencë,

është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 10 datë 16.12.2024 referuar procesverbalit të datës 16.12.2024 dhe nga nëpunësi zbatues është bërë kontabilizimi përkatës.

Rekomandim për përmirësim sistemi nr. 15 :

Të merren masa për plotësimin e fletëve të udhëtimit nëpërmjet nënshkrimit të çdo lëvizjeje të kryer nga punonjësi udhëtues. Nëpunësi zbatues në vijimësi të kontrollojë rregullshmërinë e plotësimit të fletëve të udhëtimit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Nëpunësi zbatues, Drejtuesi i mjetit. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Zbatuar.

Veprimet e ndërmarra: Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se fletët e udhëtimit janë nënshkruar nga punonjësit që kanë udhëtuar, në çdo lëvizje të kryer prej tyre. Konkretisht:

Për muajin korrik 2024 datat: 4,5,9,10,11,17,18,19,23,24,25,31.

Për muajin tetor 2024, datat: 3,4,8,9,10,16,16,17,22,23,24,31.

Për muajin nëntor, datat 5,6,7,12,13,14,15,16,19,20,21,25,26,27,28 .

Rekomandim për masa organizative nr. 16:

Nëpunësi zbatues të marrë masa për plotësimin e pasqyrave financiare të vitit 2024, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duke marrë masa korrigjuese, sikurse trajtuar në Kapitullin “Mbi sistemin e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar” të këtij raporti.

Afati: Deri në 10 prill 2025.

Statusi: Pranuar. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Personat e ngarkuar: Nëpunësi zbatues. (Referuar shkresës së KSHK nr.209/1, datë 24.9.2024).

Statusi: Në proces zbatimi.

Veprimet e ndërmarra: Afati i realizimit të rekomandimit është deri në 10 prill 2025, pra përtej afatit të kryerjes së auditimit.

Gjetja nr. 2. Mbi plotësimin e pasqyrave financiare konform kërkesave të kuadrit rregullator.	
Subjekti i audituar	KSHK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	KSHK Nëpunësi zbatues
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimi nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.
Përshkrim i Gjetjes	Situata: Rekomandimi për rregullshmërinë në plotësimin e pasqyrave financiare të vitit 2024, është në proces zbatimi për shkak të afatit sipas kuadrit rregullator.
Niveli i Riskut	I lartë
Konkluzion	Rekomandimi nuk është zbatuar për arsye se afati i zbatimit është deri në 10 prill 2025.

Rekomandim	Nëpunësi zbatues të marrë masa për plotësimin e pasqyrave financiare të vitit 2024, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duke marrë masa korrigjuese, sikurse trajtuar në Kapitullin “Mbi sistemin e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar” të këtij Raporti.
Afati i fundit zbatimit të Rekomandimit	10 prill 2025.
Statusi i rekomandimit	Pranuar. Në proces zbatimi.

V. Çështje të tjera të dala gjatë auditimit.

Gjatë procesit të auditimit nuk u trajtuan çështje të tjera.

Opinion i përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm:

- Referuar auditimit të kryer sipas procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, konstatimeve të evidentuara në raportin e auditimit;
- Në zbatim të Standardit Ndërkombëtar për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (IPPF) 2450 “Opinionet e Përgjithshme”;
- Bazuar në vlerësimet e kryera mbi krijimin, vendosjen dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshëm, mbështetur në informacion të mjaftueshëm, të besueshëm, të duhur dhe të dobishëm;

Opinionit i efektivitetit të kontrollit të brendshëm, rezulton si më poshtë vijon:

Opinionit i vlerësimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm	Përshkrimi i opinionit, baza e opinionit ²
Niveli 2-Sistem pjesërisht efektiv Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon <i>efektivisht/mirë</i> por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave.	Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon në mënyrë efektive, por u gjetën disa mangësi të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirësime në disa drejtime.

VI. FALENDERIMET

Për plotësimin e misionit të auditimit, grupi i punës falënderon Kryetarin e Komitetit Shtetëror për Kultet dhe punonjësit e institucionit, për gatishmërinë e plotë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit, krijimin e kushteve të punës, bashkëpunimin gjatë gjithë kohës

² Citimi i Standardit Ndërkombëtar për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm IFPP 2450 “Opinionet e Përgjithshme”.

së auditimit dhe trajtimin e problemeve të konstatuara nga grupi i auditimit në zbatim të standardeve të veprimtarisë audituese.

VII. FORMULARI I VLERËSIMIT

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit të kryer, mirëpresim rekomandimet, të cilat do të shërbejnë për vlerësimin e performancës së Drejtorisë së Auditimit dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për institucionin dhe subjekte të tjera që do të auditohen.

Në funksion të vlerësimit të komponentëve të performancës bashkëlidhur është Aneksi nr. 4.

“Formulari i vlerësimit/reagimit nga subjekti i audituar” i cili pasi të plotësohet, të përcillet në Drejtorinë e Auditimit së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

VIII. PLANI I VEPRIMIT

Mbështetur në nenin 16, të Ligjit nr. 114, 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm, për eliminimin e mangësive të konstatuara, rritjen e nivelit të punës, auditimi ka dhënë *rekomandime* në Aneksin nr. 1 “Përmbledhëse e Rekomandimeve” të këtij raporti.

Bazuar në nenin 12, germa d, të Ligjit 114 datë 22.20.2015, i ndryshuar, pikën nr. 3, të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 14 datë 13.2.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të brendshëm” brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e marrjes së Raportit përfundimtar të auditimit, duhet të plotësohet, miratohet si dhe të përcillet në Drejtorinë e Auditimit në Kryeministri, Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve Aneksi nr. 3, i cili është bashkëlidhur raportit përfundimtar.

Grupi i auditimit *vlerëson* se zbatimi i rekomandimeve do të ndikojë në arritjen e objektivave të Institucionit, në zbatimin më të mirë të dispozitave ligjore, ndërkohë që menaxhimi i institucionit duhet të marrë përsipër koston negative, risqet që mund të shkaktojë mos zbatimin e tyre.

GRUPI I AUDITIMIT

Engjellushe IBRALIU

Erjona HOXHA

PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE.

Nr.	REKOMANDIMET	Renditja sipas nivelit
1.	Me qëllim realizimin e një procesi efektiv të ndjekjes dhe mbikëqyrjes së fondeve për financimin e bashkësive fetare, konform përcaktimit të nenit 10 të Ligjit nr.10140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” dhe nenit 3, pika 8, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Komitetit Shtetëror për Kultet, miratuar me Urdhrin nr. 77, datë 16.5.2018, të Kryeministrit, nga KSHK të merren masa, që rregullshmëria e planifikimit, ndjekjes dhe mbikëqyrjes së mënyrës së përdorimit të fondeve, të jenë objekt shqyrtimi në mbledhjet e Komitetit, duke proceduar me dokumentimin e procesit, konform përcaktimit të nenit 9, “Mbledhja e komitetit shtetëror për Kultet” të Rregullores së Brendshme Organizimit dhe Funksionimit.	I lartë
2.	Nëpunësi zbatues të marrë masa për plotësimin e pasqyrave financiare të vitit 2024, konform përcaktimeve të Udhëzimit nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duke marrë masa korrigjuese, sikurse trajtuar në Kapitullin “Mbi sistemin e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar” të këtij Raporti.	I lartë

GRUPI I AUDITIMIT**ENGJELLUSHE IBRALIU****ERJONA HOXHA**



OBSERVACIONET/KOMENTET

Aneksi plotësohet nga grupi i auditimit pas fazës së njohjes së subjektit të audituar, me projekt raportin e auditimit dhe reagimit zyrtar të palës së audituar, mbi gjetjet dhe rekomandimet e lëna.

Komenti i gjetjes nr. 2	<i>Komenti i KSHK.</i> Në shkresën nr.27/3, datë 26.3.2025 prot. Kryeministri, dërguar nga KSHK, “Dërgohet projekt raporti i auditimit”, theksohet se: Rekomandimi është realizuar. Ky rekomandim është shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Kultet të datës 4 mars 2025.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Gjetja dhe rekomandimi është pranuar. Në komentet e paraqitura është theksuar që rekomandimi është realizuar. Nga audituesit konsiderohet sa relatuar nga subjekti i audituar por për shkak se është proceduar për realizimin e rekomandimit pas përfundimit të auditimit në terren dhe të mosdisponimit të dokumentacionit respektiv me qëllim verifikimin e tij në funksion të nxjerrjes së konkluzionit ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi duke e riadresuar dhe një herë me qëllim zbatimin e tij në vijimësi.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes ka ndryshuar referuar shkresës nr. 27/3 datë 26.3.2025.
Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk ndryshon.

GRUPI I AUDITIMIT**Engjellushe IBRALIU**

Erjona HOXHA
